Vëmendje e veçantë TBU u ka kushtuar studentëve të vitit I, për t'i ambientuar dhe mësuar me rregullat dhe kërkesat e shkollës së lartë në mënyrën e studimit, etj. Nota mesatare e realizuar në vitin e parë të Fakultetit Administrim Biznesi është 6.7. Studentët e vitit të parë pavarësisht vështiresive të pershtatjes se kalimit nga shkolla e mesme në universitet ka mundur të ruajne afërsisht të njëjten mesatare me atë të shkollës se mesme. Kjo gjë tregon përveç perpjekjeve të studentëve për të arritur rezultate edhe perkushtimin e stafit akademik të angazhuar vecanerisht në vitin e parë që ata jo vetëm të adaptoheshin me procesin e të mesuarrit në universitet por edhe të ruanin rezultatet e tyre të meparshme. Ndërsa për studentët e të Drejtës se Biznesit duket qarte që kanë arritur rezultate edhe me të mira se rezultatet e shkollës se mesme.

Pavaresisht se në 60% të lëndëve rezultojnë të ketë student mbetes, kalueshmeria për cdo vit në të dyja fakultetet dhe në gjithë TBU është mbi 90%. Rezultatet e mesipërme shpjegohen me punën e kujdesshme konkrete të pedagogëve për cdo student. Gjatë vitit akademik 2015-2016 u diplomua brezi i katert i studentëve në programet bachelor. në total në TBU u diplomuan gjithsej 13 studentë sipas programeve të studimit të paraqitur në tabelën me poshtë.

Programi i studimit	Numri i studentëve të diplomuar në vitin 2015-2016
Bachelor Administrim Biznesi/Menaxhim	6
Bachelor Administrim Biznesi/Kontabilitet & Finance	6
Bachelor Administrim Biznesi/Marketing	1
Bachelor E drejtë Biznesi	0
Total	13

D. Fleksibiliteti i struktures se programeve dhe kreditet minimale

Kreditet sipas programeve janë minimale për diplomimin në programin përkatës. Bazuar në Rregulloren e Pergjithshme, të gjithë studentëve sipas grupeve TBU i nxit dhe i ofron mundësinë e zhvillimit të më shumë lëndëve apo të më shumë ditëve të praktikës profesionale se ato të përcaktuara minimalisht për të gjitha kategoritë. Këto lëndë apo orë shtesë, sipas krediteve përkatëse iu shtohen atyre minimale, dhe kur shlyhen të gjitha detyrimet përkatëse, reflektohen në shtojcën e diplomës së secilit student së bashku me kreditet shtesë.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 studentët e vitit të tretë bachelor në Administrim Biznesi, Profili Kontabilitet dhe Finance, në vend të lëndës Kontabilitet Drejtimi ndoqen lëndën Kontabilitet Menaxherial i Avancuar e cila ishte lëndë që zhvillohej në programet e ciklit të dytë. Ky zvendësim u bë për vete faktin që studentët e profilit të Kontabilitet Finances ishin studentë me performance të lartë dhe me njohuri të mira në fushën e Kontabilitetit edhe për shkak të faktit që një pjesë e mirë e tyre në të njëjtën kohë ishin në praktika ose të punësuar në profile që kishin lidhje direkte me këto lëndë.

Në rregulloren e TBU përcaktohet se raportet mes lëndëve brenda së njëjtës kategori, mes kategorive të ndryshme formuese si dhe midis kategorive bazë dhe atyre me zgjedhje nuk janë të ngurta dhe mund të përshtaten, koordinohen e këmbëhen duke pasur si qëllim maksimizimin e përfitimit të dijeve dhe shprehive të një student të caktuar me qëllim përputhjen sa më të përshtatshme të studimeve me angazhimet e tij aktuale apo të perspektivës. Gjithashtu studentët kanë mundësinë e formës së individualizuar të mësimdhënies në rastet që përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të TBU.

Në vitin akademik 2015-2016, janë 2 studentë të Fakultetit Administrim Biznesi dhe 2 studentë të Fakultetit E drejtë Biznesi të cileve ju janë ofruar mundësite e ndjekjes së programeve të individualizuara dhe formës së individualizuar të mësimdhënies.

V. Plani mësimor, stafi akademik dhe rezultatet për programet e studimit Master

TBU - Raporti Vjetor 2015 – 2016

Në TBU, sikurse kemi përmendur më përpara, funksionojnë edhe programet e studimit në nivel master shkencor dhe profesional. Sipas planit mësimor të miratuar, mësimi zhvillohet mbi bazë modulesh, d.m.th. lëndët zhvillohen me cikle. Pedagogët që mbulojnë ngarkesën plotësojnë të gjithë kualifikimin e nevojshëm.

Sipas programit kalëndarik të zhvillimit të moduleve, për vitin akademik 2015-2016 për të gjitha programet master në TBU, janë zhvilluar modulet e mëposhtme:

Nr.	Moduli	Ore gjithsej	Pedagogu	Grada	Nr. Stud	NF+NP	Kaluan	Kalueshmëria %
1	Menaxhimi i Mardhenieve me klientin	60	Gerti Dajci	Doktor	23	2	21	100
2	Menaxhim Strategjik	60	Gerti Dajci	Doktor	11	1	10	100
3	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit (MIS)	60	Bojken Shehu Endri Mataj	Doktor Msc.	12	1	11	100
4	Kontabilitet Menxherial I Avancuar	60	Lindita Milo (Lati) Redvin Marku	Prof. Dr. Doktorant	71	29	31	74
5	Drejtim Financiar I Avancuar	60	Ornela Kembora	Doktor	71	21	41	82
6	Menaxhim i Riskut Financiar	60	Andi Habilaj	ME	22	2	18	90
7	Menaxhim Projektsh	60	Egland Pupa Lida Xhengo	ME Msc.	29	3	26	100
8	Menaxhimi i cilesise	60	Arjan Qefalia	Doktor	16	5	11	100
9	Sjellje Organizative	60	Blendi Shima	Doktor	2	0	2	
10	Taksim i Biznesit	60	Jordan Daci Abaz Aliko Enkeleida Pipa	Prof. Asoc. Doktorant Msc.	67	17	45	90
11	E drejtë Biznesi	60	Endri Papajorgji	Prof.Asoc.	41	17	19	79
12	E rejeta Fiskale e Krahasuar	60	Jordan Daci Abaz Aliko Enkeleida Pipa	Prof. Asoc. Doktorant Msc.	41	12	25	86
13	E Drejta Administrative Europiane	60	Juliana Latifi Gracienne Lauëers	Prof. Dr. Doktor (PhD)	17	0	17	100

Tabelat me lart tregojnë qartë që gama e lëndëve të ofruara gjatë këtij viti akademik është e gjere. në total për programet master në të dy Fakultetet janë zhvilluar rreth 780 orë mësimore.

Ne kuader të ofrimit të kurseve për sigurimin e kualifikimit të vazhduar, TBU gjatë këtij viti lëndët ‘E Drejta Administrative Europiane’, ‘Taksim i Biznesit’ si edhe e ‘Menaxhim Projektsh’ i ofroi edhe për jo-studentë. Pjesëmarrësit jashtë TBU ishin 5 për lëndën Taksim i Biznesit, 4 për lëndën

E drejta Administrative Europiane dhe 3 për lëndën Menaxhim Projektsh. në fund të zhvillimit të kesaj lëndë të gjithë pjesemaresit u paisen me certifikata.

Ne total numri i pedagogeve të angazhuar në programet master për të dy fakultetet është 17. në tabelën me poshtë është një përmbledhje e numrrit të pedagogeve sipas gradave dhe titujve.

Nr.	Titulli (grada)	Nr.	Përqindja
1.	Profesorë	2	11.8
2	Profesore të asocuar	2	11.8
3	Doktorë	6	35.1
4	Doktorant	2	11.8
5	Mater ekzekutiv	2	11.8
6	MSc.	3	17.7
Totali		17	100

Tabela me lart tregon se 70% e pedagogeve janë me gradën shkencore doktor, në process doktorature dhe të kategorise Profesor. në të gjitha lëndët e zhvilluara në programet master për kete vit akademik titullari i lëndës është me gradën doktor ose me titujt akademik Profesor apo Profesor i asocuar.

Referuar rezultateve të tabelës me lart vihet re se kalueshmeria mesatare në të gjitha programet master është 85%. Kjo tregon një cilesi të larte të realizimit të mësimit nga stafi akademik i TBU duke bërë e mundur që konceptet të jene të qarta dhe të perthithen në pjesen me të madhe gjatë zhvillimit të mësimit.

Ne vazhdimesi të procesit të ndermare një vit me parënë lidhje me perpjekjet për riaktivizim për studentët e rregjistruar në vitet e meparshme, duke parëse një pjese e tyre kane perfunduar detyrimet me të shumta ndaj programit mësikor përkatës, dhe ju ka mbetur vetem 1-2 provime dhe/ose vetem mbrojtja e praktikës dhe diplomes, me vendim të Rektorrit të TBU ju pezulluan studimet. Ky vendim është marre për një numer prej 28 studentësh nga të dy fakultet. Me poshtë është një tabelë që tregon pikerisht kete shperndarje të sudenteve për të ciet u bë vendim pezullimi studimesh pa afat, sipas programit të studimit dhe fakultetit.

Fakulteti Administrim Biznesi (AB)	Nr. Studentëve
Master Profesional AB/Kontabilitet & Finance	6
Master Profesional AB/Menaxhim	7
Master Profesional AB/E drejtë Biznesi	2
Master Profesional Administrim Publik	5
Total AB	20
Fakulteti E drejtë Biznesi (EDB)	
Master Profesional E drejtë Biznesi	8
Total EDB	8
Total TBU	28

Në vitin akademik 2015 – 2016 u diplomuan gjithsej 2 studentë në programet master, 1 student në programin Master Profesional në Administrim Biznesi dhe 1 student në programin Master Shkencor në Administrim Biznesi.

Programi i studimit	Numri i studentëve të diplomuar në vitin 2015-2016
Master Profesional Administrim Biznesi	1
Master Shkencor Administrim Biznesi	1
Total	2

VI. Aftësimi praktik i studentëve

Aftësimi praktik i studentëve në TBU përfshin praktikat profesionale (internship) të organizuara nga shkolla, punësimi i studentëve në pozicione punë kompaktibel me formimin profesional në Administrim Biznesi ose E drejtë Biznesi si dhe aktivitete ekstra kurrikulare të tilla si trajnime specifike, seminare special, biseda me menaxherë, jurist, profesionistë, sipërmarrës apo përfshirje e studentëve me rol në studime tregu dhe shërbime për sipërmarrje të ndryshme apo në organizimin e aktiviteteve të ndryshme të shkollës.

A. Praktika profesionale

Përveç rastit kur studenti është i punësuar në një punë kompaktibel me studimet cdo student tjetër angazhohet në praktika profesionale (internship) si rregull të mundësuar nga shkolla dhe si përjashtim të gjetur nga vetë studenti por me miratim të shkollës. Mundësitë e TBU për praktikat e studentëve vazhduan të rriten në vitin akademik 2015-2016. Një numër i madh studentësh realizuan rreth 8 javë praktike për vitin e parë bachelor, rreth 16 jave për vitin e dytë dhe 24 javë në vitin e tretë, dhe deri në 6-8 muaj sipas tipologjise së programit përkatës master. Gjatë këtij viti akademik u arrit objektiv i kryerjes se 12 muajve praktikë profesionale gjatë studimeve bachelor.

Në projektin e zgjatur të praktikave morrën pjese 28 studentë bachelor të cilët kanë zhvilluar praktikat me një shpërndarje nga 24 deri në 48 jave. Kryerja e praktikave të zgjatura jo vetem ndikon në formimin praktik të studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës, por ajo gjithashtu rezultoi se rriti shanset e punësimit të një numri të madh të tyre. Në seksion C më poshtë jepen rezultatet e punësimit të studentëve edhe gjatë kohës që vazhdojnë studimet.

Bazuar në këtë sukses, TBU do të mundësojë zhvillimin e praktikave akoma më të zgjatura duke ju dhënë mundësi studentëve të fitojnë edhe kredite shtesë prej tyre.

Lidhur me studentët e punësuar në pozicione punë kompaktibel me studimet, shkolla komunikon me studentin dhe punëdhënësin për të vlerësuar shkallën e fitimit të aftësive përmes punës në mënyrë që studenti të përfitojë kreditet e duhura të praktikës profesionale. Në programet master studentit të punësuar i kerkohet që në mirekuptim me punëdhënësin të zhvillojë një mikroprojekt në përfitim të biznesit ku punon mbi të cilin ky student vlerësohet.

B. Seminare trajnimi, leksione të hapura, vizita studimore, simpoziume

TBU, krahas procesit mësimor të pasqyruar në kurrikulën e shkollës, gjatë viti akademik 2015-2016 ka zhvilluar edhe veprimtari të tjera akademike. Ajo në mënyrë të përmbledhur mund të paraqitet në rubrikat e mëposhtëme.

A. Seminare shkencore/ Trajnimi	Referues/Pjesëmarrës	Organizator	Koha
Sipërmarrje dhe Kreativitet	Edona Bilali , Administratore dhe Ortake, AZ Consulting dhe Rezart Prifti , Menaxher, CustomEyes / Pjesëmarrës ishin mbi 60 studentë, përfaqësues nga kompani, etj.	Organizata LeadCo në bashkëpunim me TBU, ProCredit Bank, etj.	Tetor, 2015
Kodi i Punës në Shqipëri	Antonio Vito P. Boccia , pedagog në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën, UAMD / Pjesëmarrës ishin mbi 80 përfaqësues nga biznesi, institucione, organizata jofitimprurëse dhe student bachelor e master	TBU & Italian Netëork	Nëntor, 2015
E Drejta e Sigurisë e Personit dhe paraburgimi në RSH sipas legjislacionit vendas dhe standarde të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut	Jordan Daci , pedagog, Tirana Business University, Jorida Rustemi , Drejtuese e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Institucioni i Avokatit të Popullit; Fatmira Laskaj , Shoqata e Avokatëve Penalistë; Sajmir Vishaj , Kryetar i Shoqatës së Avokatëve Penalistë; / Pjesëmarrës ishin mbi 50 oficerë të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, oficerë të policisë së dhomave të ndalimit, avokatë dhe kandidatë për avokatë, studentë, etj.	Jordan Daci (TBU) & Institucioni i Avokatit të Popullit, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shoqata e Avokatëve Penalistë.	Dhjetor, 2015
Siguria dhe mbrojtja e shëndetit në punë. Krahasim midis legjislacionit Evropian, Italian dhe Shqiptar	Antonio Vito P. Boccia , pedagog në FASTIP, UAMD dhe Anjeza Dajzmaili , pedagoge në Tirana Business University. Pjesëmarrës ishin mbi mbi 80 përfaqësues nga bizneset shqiptare dhe italiane, bota akademike, organizata jofitimprurëse, studentë, etj.	Italian Netëork në bashkëpunim me TBU dhe Camera di Commercio Italiana in Albania	Mars, 2016
B. Seminare special/Leksione të hapura/te ftuar	Referues/Pjesëmarrës	Organizator	Koha
Historiku, zhvillimi dhe projektet e ardhshme të Balfin Group; karriera në Balfin Group dhe eksperiencia personale e Znj. Muka, CEO	Edlira Muka , CEO, Balfin Group / Pjesëmarrës ishin student bachelor dhe master dhe pedagogë të TBU	TBU	Tetor, 2015
Programi Shitjet Direkte nga Studentët, mundësi për aftësim profesional dhe punësim	Denisa Habilaj , Drejtuese Ekipi, SDS, Raiffeisen Bank Albania / Pjesëmarrës ishin student bachelor/master dhe pedagogë të TBU	TBU	Tetor, 2015
Çështjet administrative e juridike në regjistrimin e shoqërive tregtare, akteve	Vasilika Vjero , Drejtoreshë e QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) dhe Ilda Koja , Drejtoreshë e Regjistrimeve, QKR / Pjesëmarrës	TBU	Nëntor, 2015

TBU - Raporti Vjetor 2015 – 2016

dhe dokumentacioni shoqëruar	ishin student bachelor/master, pedagogë të TBU dhe përfaqësues nga kompanitë partnere		
Sipërmarrja shqiptare – Histori suksesi	Andi Memi dhe Eris Hoxha , bashkëthemelues të zyrës së konsulencës ligjore “HM&H / Pjesëmarrës ishin student bachelor dhe master, pedagogë, si dhe të interesuar të tjerë.	TBU	Nëntor, 2015
Sipërmarrja shqiptare – Histori suksesi	Brisida Gega , sipërmarrëse dhe administratore e fasonerisë A&ENI shp / Pjesëmarrës ishin studentë, pedagogë, si dhe të interesuar të tjerë.	TBU	Nëntor, 2015
Historiku, shërbimet dhe zhvillimi i AZ Consulting; karriera e znj. Bilali; mundësitë për praktikë e punësim të studentëve	Edona Bilali , administratore/ortake, AZ Consulting / Pjesëmarrës ishin student bachelor dhe master, pedagogë, si dhe të interesuar të tjerë.	TBU	Nëntor, 2015
Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit; Tregtia on-line dhe promovimi i biznesit përmes social media dhe aplikacioneve	Drritan Mezini , Themelues & CEO i kompanisë DM Consulting Services dhe Tomi Kallanxhi , themelues, ëëë.shpi.al dhe ëëë.gati.me / Pjesëmarrës ishin student bachelor/master dhe pedagogë të TBU.	TBU	Maj, 2016
Formimi profesional dhe punësimi i studentëve në kompaninë Neptun dhe Final	Majlinda Gjata , CEO e Fin-Al, Irma Shkrepa , Drejtoreshë e Shitjeve në Neptun, Elvin Nosi , Drejtor i Burimeve Njerëzore në Neptun / Pjesëmarrës ishin student bachelor/master dhe pedagogë të TBU.	TBU	Shtator, 2016
C. Forum diskutimi	Referues/Pjesëmarrës	Organizator	Koha
Monitorimi i efektivitetit të gjykatave administrative në vitin e dytë të punës. Paraqitja e studimit, sondazhi me bizneset, problematika dhe rekomandime	Ylli Manjani , Ministri i Drejtësisë, Gjergj Buxhuku , Administrator i Përgjithshëm, Konfindustria, Eriol Roshi , Kryetari i Gjykatës Administrative të shkallës së parë Tiranë, Kastriot Selita , Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit / Pjesëmarrës ishin student, pedagogë të TBU dhe përfaqësues nga kompanitë partnere, institucionet publike, etj.	Konfindustria, Ministria e Drejtësisë, Fondacioni Friedrich Ebert, me mbështetjen e TBU	Korrik, 2016

Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet e përmendura më lartë është një nga metodat kryesore që TBU përdor për aftësimin praktik të studentëve. Nëpërmjet tematikave të ndryshme të trajtuara në këto aktivitete studentët njihen me problematikat aktuale të bizneseve, institucioneve publike si dhe të ekonomisë në tërësi.

C. Punësimi i studentëve

Ashtu si edhe përmendet në Strategjinë e TBU, të përditëuar, objektivi numër 1 i TBU është të formojë studentë me dije teorike dhe aftësi praktike të tilla që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull para mbarimit të ciklit Bachelor dhe/ose brenda ciklit Master. Në këtë kuader TBU nëpërmjet vendimarrjes së strukturave të saj drejtuese për zhvillimin e mësimin ka mundur që studentët të zhvillojnë paralelisht me mësimin

praktikat apo të jene të punësuar. TBU gjithashtu ndjek hap pas hapi punësimin e të diplomuarve të saj edhe pasi kane mbaruar studimet.

Nga një vlerësim i fundit i bërë për punësimin e të gjithë të diplomuarve deri tani, rezultojne shifrat e paraqitura në tabelën me poshtë.

Programi i Studimit	Studentë te Diplomuar	Studentë Te punësuar/ngjitje në kariere
Te diplomuar Bachelor deri në fund të 2015-2016	60*	54
Te diplomuar në Master (punësim/ngjitje në kariere) deri në fund të 2015-2016	18	18
Te sapo diplomuar në vitin e trete bachelor 2015-2016	13	13

* të gjithë janë aktualisht studentë në programet master në TBU.

Shifrat e punësimit të studentëve të TBU edhe gjatë studimeve bachelor tregojnë se studentët që pergatiten në auditoret e TBU janë konkurente të forte në tregun e punës edhe pa mbaruar akoma studimet bachelor. Tabela me poshtë tregon nivelin e punësimit të studentëve të vitit të dyte dhe të trete bachelor në Dhjetor të vitit 2016.

Programi i Studimit	Numri total i Studentëve	Studentë Te punësuar
Bachelor Viti Dyte	82	28
Bachelor Viti Trete	65	34

Gjithashtu 64 studentë, nga 108 që janë në vitin e parëbachelor, në Dhjetor 2016, pervec angazhimit në praktikat mësimore janë punësuar 1 – 4 javë me pagesë (punësim sezonal).

Praktikat mësimore të mundësuar për studentët nga TBU paralelisht me zhvillimin e mësimit në auditor kane bërë të mundur qe, deri në Dhjetor 2016, 47 studentë të perfundojne të punësuar permes ketyre praktikave, 7 nga Banka Raiffeisen, 12 nga kompanite e Grupit Balfin dhe 28 nga kompani të tjera. Ndërsa 23 studentë, bachelor ose Master kane marre rol drejtues në bizneset familjare.

D. Inkubatori i Biznesit Studentor

Zhvillimi i njohurive praktike dhe sidomos përkrahja e zhvillimit të iniciativës së lirë dhe sipërmarrjes tek studentët, jo vetëm që përmbush një nga objektivat e TBU, por përbën edhe një kontribut në zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kuadër, TBU ka zhvilluar projektin: “**Inkubatori i Biznesit Studentor**” përmes së cilit mbështeten nisma sipërmarrëse të studentëve të TBU. Inkubatori i biznesit vë në dispozicion të këtyre nismave falas mjedise fizike të shkollës, pajisje, lidhje në internet, këshillim nga stafi akademik ose persona me eksperiencë, mundësi për bashkëpunim me bizneset partnere për të siguruar suportin e tyre financiar dhe teknik. Dy studentë të TBU janë në hapat e para të krijimit të biznesit të tyre përmes projektit “inkubatori i Biznesit Studentor”.

VII. Aktivitete të tjera të zhvilluara nga TBU

A. Konferencat Shkencore dhe punime shkencore të stafit akademik të TBU

Gjatë vitit akademik 2015-2016 janë organizuar katër konferenca shkencore. Keto konferenca janë organizuar në bashkepunim edhe me Dhomen Kombetare të Ndermjetesve dhe Kolegjin Pjeter Budi në Prishtinë.

- ICIS II- u zhvillua në 19 Dhjetor 2015 ku morren pjese 60 profesore e kerkues shkencore nga Shqiperia, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Turqia etj. në kete konference u prezantuan 52 punime në tre disiplina të ndryshme, ekonomike, juridike dhe multidisiplinare.
- ICIS III- u zhvillua në 5 Mars 2016 ku morren pjese 65 profesore e kerkues shkencore nga Shqiperia, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Turqia etj. në kete konference u prezantuan 55 punime në tre disiplina të ndryshme, ekonomike, juridike dhe multidisiplinare.
- ICIS IV- u zhvillua në 11 Qershor 2016 ku morren pjese 60 profesore e kerkues shkencore nga Shqiperia, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Turqia etj. në kete konference u prezantuan 50 punime në tre disiplina të ndryshme, ekonomike, juridike dhe multidisiplinare.
- ICBLAS IV – u zhvillua në 1 Tetor 2016 ku morren pjese 55 profesore e kerkues shkencore nga Shqiperia, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Turqia etj. në kete konference u prezantuan 48 punime në tre disiplina të ndryshme, ekonomike, juridike dhe multidisiplinare.

Per cdo conference të organizuar është bërë botimi i revistes përkatëse me punimet. të gjitha botimet e konferencave janë të indeksuara në Google Scholar.

Pavec pjesemarrjes në konferencat e organizuara nga TBU stafi akademik i TBU ka kryer punime shkencore të cilat i ka referuar apo botuar në konferenca të organizuara nga institucione të tjera ose i ka botuar në revista të tjera shkencore. Gjatë vitit akademik 2015-2016 janë kryer gjithsej 84 punime shkencore (referime në konferenca, botime në revista shkencore apo monografi etj.) nga stafi akademik i angazhuar në TBU. Kjo liste është publikuar në faqen e ëeb-it të TBU.

B. Konkursët “Sipërmarrësit e së Nesërmes” dhe “Juristet e së Nesërmes”

Në përpjekjen e tij për realizimin e misionit për edukimin e studentëve në fushën e biznesit dhe ligjeve të biznesit, Tirana Business University me mbështetjen e pakursyer të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorive Arsimore Rajonale, për të gjashtin vit radhazi, organizoi konkursin kombëtar “Sipërmarrësit e së Nesërmes”, edicioni i gjashtë, dhe për herë të dyte, “Juristet e së Nesërmes, me maturantët e shkollave të mesme publike dhe private në qytetet kryesore të Shqipërisë për vitin akademik 2015-2016 gjatë periudhës Shkurt-Maj 2015.

U regjistruan 120 ekipe të “Sipërmarrësit e së Nesërmes” dhe 50 ekipe të “Juristet e së Nesërmes.

Për fituesit e konkursit “Sipërmarrësit e së Nesërmes” u ofruan 2 kategori të çmimeve speciale nga kompanitë partnere, 12 kategori të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe 9 kategori të çmimeve bazuar në performancën si ekip nga TBU, ndërsa për fituesit e konkursit “Juristët e së Nesërmes” u ofrua 1 kategori e çmimeve speciale, 6 kategori të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe 5 kategori të çmimeve bazuar në performancën si ekip nga TBU.

TBU në partnerritet me Credins Bank, RTV Scan, Balfin Group, Agna Group, Sigal, Kalo, HMM, Eölftheiss, akordoi në total 35 kategori të çmimeve. Fituesve të çmimeve speciale iu akordua mbështetje teknike e financiare nga partnerët kryesorë si dhe bursë studimi 100% për të treja vitet e studimit bachelor, ndërsa fituesve të çmimeve bazuar në performancën individuale dhe në ekip iu akordua bursë studimi 40% për një vit akademik bachelor.

VIII. Funksionimi i Organeve Akademike dhe Manaxhimi Administrativ i TBU

A. Funksionimi i organeve akademike

TBU është organizuar dhe funksionon me dy fakultete: Fakulteti i Administrimit të Biznesit dhe Fakulteti i të drejtës së Biznesit. Secili fakultet ka tre departamente: të lëndëve të përgjithshme të lëndëve të specialitetit dhe qendren për kerkime ekonomike/juridike.

Funksionet, detyrat dhe kompetencat e instancave të sipërme janë përcaktuar hollësisht në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.

Senati ka funksionuar rregullisht sipas statutit dhe ka marre vendimet përkatëse për funksionimin e TBU, si vendimi për struktuuren akademike, planet mësimore, projekt buxhetin tre vjeçar.

Gjatë këtij viti akademik Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilesise (NjBSC) ka ushtruar funksionet e saj për sigurimin e cilesise në perputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e TBU. Në përmbushje të detyrave të saj, NjBSC kryen vlerësime dhe kontrole të vazhdueshme për të siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë pranë TBU, si dhe duke mundësuar rekomandime në lidhje me gjetjet dhe për të siguruar një rritje të vazhdueshme të cilësisë pranë këtij institucioni.

Në këtë kuadër, për vitin 2015-2016, NjBSC ka vlerësuar si prioritet analizimin e treguesit të cilësisë së ndërlidhjes së njohurive teorike me ato praktike. Nga analiza e bërë NjBSC konkludon se TBU ka arritur marrëveshje të shumta me institucione dhe biznese për t’ju mundësuar studentëve praktika mësimore profesionale. Këto praktika në shumicën e rasteve kanë qenë aq të sukseshme, saqë janë kthyer me vullnetin e bizneseve në punësime me pagesë për studentët.

Në kuadër të përmbushjes së këtij objektivi cilësor, Njësia konstaton që nga TBU janë marrë masa tepër cilësore që mundësojnë përmbushjen e tij. Në këto masa, mund të vihet në pah, organizimi i mësimit mbasdate për vitet nga viti i dytë i studimit e më lartë, ngritjen dhe funksionimin e një sistemi raportimi periodik dhe cilësor mbi praktikën mësimore të zhvilluara, ndjekjen e ecurisë së praktikave profesionale të zhvilluara nga stafi përkatës, mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me institucionet dhe bizneset për të marrë të dhëna për ecurinë e praktikës dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës të secilit student etj.

B. Menaxhimi administrativ

Nisur nga numri i kufizuar i fakulteteve dhe i punonjësve dhe fakti që tërë veprimtaria realizohet në një ndërtesë administrimi i Institucionit është realizuar në mënyrë të përqëndruar nga Administratori. Për arsyet që përmendëm fakultetet nuk kanë personel mbështetës.

Në rang Institucioni funksionon një sekretari, e cila mbulon edhe problemet e fakulteteve të veçanta. Sekretaria mbulon edhe funksionet e Arkivës dhe protokollit.

Rektori

Prof. Dr. Lavdosh Zaho